EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8438
E martë, 24 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Promovohet “Libri i lirisë - gjurmë në kohë vendimtare” i gazetarit Nuhi Bytyçi

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SA LARG MUND TË SHKOJË DORA E SHTETIT NË HAGË?

FAQE 4-5



Liderët e UÇK-së janë duke u përgatitur që ta kundërshtojnë në apel aktgjykimin e shkallës së parë në Hagë. Në këtë proces ata pritet të mbështeten edhe nga institucionet e Kosovës, të cilat kanë nisur hartimin e një strategjie për të kontribuar në përpjekjet e tyre juridike. Ekspertët e së drejtës penale ndërkombëtare kanë vlerësuar se ndihma financiare dhe ekspertiza juridike janë të ligjshme dhe mund të jenë të dobishme, por nuk garantojnë ndryshimin e aktgjykimit. Ata kanë identifikuar çështje që mund të kundërshtohen gjatë procesit të apelit, ndërsa kanë shprehur rezerva për përpjekjet për ta ndryshuar ligjin mbi të cilin funksionon Gjykata Speciale

GJERMANIA KONFIRMON KOORDINIMIN ME SHBA-në PËR TË ARDHMEN E KFOR-it F. 3



SHKK-JA SHËNON 27-VJETORIN, HAXHIU DHE KURTI VLERËSOJNË RËNDËSINË E SIGURISË DHE REHABILITIMIT TË TË BURGOSURVE F. 6



OPINION

DINJITETI I SHEMBUR F. 7



Shkruan:
Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

AKTUALE



KONJUFCA: REPUBLIKA E KOSOVËS E KA DËSHMUAR PËRKUSHTIMIN E SAJ NDAJ INTEGRIMIT EVROPIAN F. 3

HARADINAJ PARA NXËNËSVE NË DEÇAN FLET PËR HISTORINË, SAKRIFICËN E UÇK-së DHE RRUGËTIMIN DREJT LIRISË F. 6

EKONOMI



NIS ZBATIMI I SISTEMIT TË PAGESAVE TË SHPEJTA TIPS-K, REALIZOHEN ME SUKSES EDHE TRANSFERET E PARA TË MENJËHERSHME F. 8

BIZNESET KËRKOJNË MBËSHTETJEN E QEVERISË PËRBALLË REDUKTIMEVE TË RRYMËS DHE SHTRENJTIMIT TË PRODHIMIT F. 8

SPORT

PRISHTINA E FORCON KREUN, MALISHEVA MBETET E DYTA, DRITA DHE BALLKANI SHËNOJNË FITORE NË XHIRON E 14-t F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHQIPËRIA MOHON PËRFSHIRJEN NË SULMIN ME DRON NDAJ KORVETËS RUSE: TERRITORI YNË NUK U PËRDOR PËR SULMIN

Tiranë, 23 nëntor - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë ka mohuar pretendimet se sulmi me dron detar ndaj një korvete ruse është nisur nga territori shqiptar. Përmes një reagimi publik, ministria i ka cilësuar këto raportime të pasakta dhe në kundërshtim me faktet, duke theksuar se Shqipëria nuk ka pasur asnjë përfshirje në incident dhe se territori i saj nuk është përdorur apo vënë në dispozicion për nisjen ose lehtësimin e një sulmi të tillë.

Ministria i ka hedhur poshtë kategorikisht këto pretendime, duke thënë se janë publikuar pa prova të verifikueshme. Ajo u ka bërë thirrje përgjegjësve për përhapjen e tyre që t'i korrigjojnë informacionet dhe të tregojnë saktësi e përgjegjësi në raportimin e çështjeve të ndjeshme. "Ne kemi marrë dijeni për raportimet që pretendojnë se sulmi me dron detar ndaj një korvete ruse ka nisur nga territori shqiptar. Raportimet në fjalë janë të pasakta dhe nuk pasqyrojnë faktet. Shqipëria nuk ka qenë e përfshirë në këtë incident dhe territori i saj as nuk është përdorur, as nuk është vënë në dispozicion për nisjen apo lehtësimin e një sulmi të tillë. Ne i hedhim poshtë kategorikisht këto pretendime, të cilat janë paraqitur pa prova të verifikueshme. U bëjmë thirrje përgjegjësve për përhapjen e tyre që t'i korrigjojnë informacionet dhe të tregojnë saktësi, kujdesin e duhur dhe përgjegjësi gjatë raportimit për çështje kaq të ndjeshme", është thënë në reagimin e ministrisë.



RUTTE U BËNË THIRRJE ALEATËVE TË NATO-s: MBËSHTETJA USHTARAKE PËR UKRAINËN DUHET TË VAZHDOJË, PUTINI NUK DUHET TË FITOJË



Berlin, 23 nëntor - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, u ka bërë thirrje aleatëve të Aleancës ta vijojnë mbështetjen ushtarake për Ukrainën, duke theksuar se pajisjet dhe ndihma ushtarake që dërgohen në vend janë të domosdoshme, veçanërisht përpara afrimit të sezonit të dimrit. Gjatë një deklarate në Berlin, Rutte ka paralajmëruar se Rusia po vazhdon ta forcojë ekonominë e saj të luftës dhe se kërcënimi nuk do të zhduket edhe nëse një ditë përfundon lufta në Ukrainë. "Ne duhet t'i tregojmë Putinit se përpjekjet e tij për ta dobësuar mbështetjen tonë do të dështojnë. Ndihmoni të ruani atë mbështetje për aq kohë sa të duhet", ka deklaruar Rutte.

Ai ka theksuar se aleatët duhet të jenë të përgatitur përballë rreziqeve të sigurisë dhe të mos lejojnë që Rusia ta minojë unitetin e NATO-s. "Ekonomia e luftës e Rusisë vazhdon të rritet dhe nuk do të qëndrojë në vend kur lufta kundër Ukrainës, shpresojmë, të përfundojë një ditë", është shprehur kreu i NATO-s.

Rutte ka kërkuar gjithashtu rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen, duke u bërë thirrje vendeve anëtare të krijojnë plane konkrete dhe të besueshme për investimet ushtarake. "Duhet ta bëjmë të qartë se ata do të dështojnë", ka përfunduar ai, duke nënvizuar rëndësinë e ruajtjes së mbështetjes politike dhe publike për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Aleancës.

UKRAINA ME SYTË NGA NATO-ja, ZELENSKY: DIMRI PO VJEN, KEMI NEVOJË PËR JU

Kiev, 23 nëntor - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka paralajmëruar NATO-n për sfidat që e presin Ukrainën gjatë muajve të dimrit, duke kërkuar mbështetje shtesë për forcimin e mbrojtjes ajrore.

Duke iu drejtuar përmes një lidhjeje virtuale Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Berlin, Zelensky ka theksuar se Ukraina ka nevojë urgjente për sisteme të avancuara të mbrojtjes ajrore, veçanërisht për sistemet amerikane "Patriot". "Ndërsa përgatitemi për këtë dimër, padyshim që kemi nevojë për mbështetjen tuaj. Prioriteti ynë numër një është mbrojtja ajrore. Na duhen sisteme 'Patriot'", ka deklaruar Zelensky. Ai ka shtuar se sa më e fuqishme të jetë mbrojtja ajrore ukrainase, aq më të vogla do të jenë mundësitë e Rusisë për ta dobësuar atë.

Presidenti ukrainas ka folur edhe për mundësinë e negociatave trepalëshe ndërmjet Ukrainës, Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, duke shprehur shpresën që ato të zhvillohen sa më shpejt.

Deklaratat vijnë pas raportimeve se presidenti amerikan, Donald Trump, synon arritjen e një marrëveshjeje për përfundimin e luftës deri në janar. "Duhet të shkojmë në këtë takim me një agjendë të qartë, të dakorduar nga të gjithë ne. Përgatitja e fortë dhe e përbashkët do të sjellë rezultate të forta", ka theksuar Zelensky.

Thirrja e tij vjen në një kohë kur Ukraina po përgatitet për muajt e ftohtë, ndërsa sulmet ruse vazhdojnë të përbëjnë kërcënim për vendin.



SULM KIBERNETIK NDAJ FBI-së, TRUMPI: MUND TË ZBULOJMË INFORMACIONE QË NUK DO T'I DINIM KURRË



Uashington, 23 nëntor - Hakerët dyshohet se kanë depërtuar në Qendrën Kombëtare të Informacionit për Krimin (NCIC), një bazë të dhënash që përdoret nga agjencitë e zbatimit të ligjit në ShBA për verifikimin e urdhër-arresteve dhe të dhënave kriminale. Sipas raportimeve të "Fox News" dhe "CNN", ky është incidenti i dytë kibernetik ndaj sistemeve të FBI-së brenda dy muajsh. Lidhur me ngjarjen ka reaguar edhe presidenti Donald Trump, i cili ka deklaruar për "Fox News" se sulmi mund të zbulojë informacione të panjohura më parë, përfshirë ato që lidhen me hetimet për fushatën e tij presidenciale të vitit 2016. Megjithatë, nuk ka asnjë provë që sulmi lidhet me këtë çështje.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

GJERMANIA KONFIRMON KOORDINIMIN ME SHBA-në PËR TË ARDHMEN E KFOR-it



Prishtinë, 23 nëntor - E ardhmja e trupave amerikane në Kosovë mbetet e paqartë, ndërsa Shtetet e Bashkuara po rishikojnë praninë e tyre ushtarake në Evropë.

Gjermania ka konfirmuar se është në koordinim të vazhdueshëm me Uashingtonin dhe aleatët e NATO-s për të ardhmen e misionit paqeruajtës, KFOR, por nuk ka sqaruar nëse po diskutohet edhe reduktimi i trupave amerikane. "Forcat amerikane luajnë rol të rëndësishëm në KFOR", ka thënë një zëdhënës i Ministrisë gjermane të Mbrojtjes për "Radion Evropa e Lirë".

I pyetur nëse me aleatët është diskutuar mundësia e reduktimit të kontingjentit amerikan në Kosovë, ai ka thënë: "qeveria gjermane është në koordinim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me NATO-n dhe aleatët e saj, përfshirë Shtetet e Bashkuara, lidhur me të ardhmen e KFOR-it".

Ai ka shtuar se hollësitë e planifikimit të misionit nuk mund të bëhen publike për arsye sigurie.

Përgjigjja vjen pas konsultimeve të 17 nëntorit në Bruksel, ku aleatët e NATO-s kanë diskutuar me zyrtarin e lartë të Pentagonit, Elbridge Colby, për të ardhmen e pranisë ushtarake amerikane në Evropë. Para takimit, ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ka thënë se priten ndryshime në numrin e trupave amerikane, por se përmasat e tyre mbeten të paqarta.

Ai ka theksuar nevojën për koordinim me Uashingtonin, në mënyrë që të shmangen boshllëqet në mbrojtjen evropiane. Pas konsultimeve, Colby ka thënë se shpreson që rishikimi i pranisë ushtarake amerikane në Evropë të përfundojë deri më 1 dhjetor. Ai nuk ka konfirmuar nëse do të ketë reduktim të trupave, por ka thënë se ShBA-ja duhet t'i shpërndajë forcat sipas nevojave të saj globale, përfshirë angazhimet në rajonin e Indo-Paqësorit. Megjithatë, ai ka theksuar se kjo nuk nënkupton tërheqjen e ShBA-së nga angazhimet në Evropë.

A pritet reduktim i trupave amerikane në Kosovë?

Autoritetet amerikane kanë paralajmëruar tashmë ndryshime në kontributin e tyre në KFOR. Në qershor, Komanda Evropiane e ShBA-së ka konfirmuar se do ta përshtatë gradualisht kontributin amerikan në mision, në përputhje me planet e NATO-s. Sipas një zyrtari të saj, përshtatja do të bëhet në faza, bazuar në vlerësimin e rrezikut. Në përgjigjen për "Radion Evropa e Lirë" më 16 qershor, ai nuk ka specifikuar numrin e ushtarëve që mund të preken nga ndryshimet. Një kërkesë tjetër për sqarime iu dërgua Departamentit amerikan të Mbrojtjes më 20 nëntor, por mbeti pa përgjigje.

Ndërkohë, një burim i "Radios Evropa e Lirë", i cili ka kërkuar të mbetet anonim, ka thënë se ekziston një plan për reduktimin e ndjeshëm të pranisë ushtarake amerikane në Kosovë. Sipas tij, numri i pjesëtarëve amerikanë mund të ulet nga rreth 650 aktualisht në afërsisht 50 deri në shkurt të vitit 2028.

Synimi, sipas burimit, është që brenda dy vjetësh ShBA-ja të ketë vetëm një rol të kufizuar ushtarak në Kosovë, ndërsa disa pozita mund të mbeten në shtabin e KFOR-it, në kampin Film City në Prishtinë. "Radio Evropa e Lirë" nuk ka mundur t'i verifikojë në mënyrë të pavarur këto informacione. Autoritetet amerikane dhe NATO-ja nuk kanë njoftuar publikisht për një plan të tillë.

Çfarë ndryshimesh ka paralajmëruar NATO-ja?

Në qershor NATO-ja ka njoftuar se do ta përshtatë gradualisht praninë e saj ushtarake në Kosovë, me synimin që brenda një viti numri i trupave të kthehet në nivelet e para vitit 2023. Vendimi është arsyetuar me përmirësimin e situatës së sigurisë. NATO-ja kishte dërguar përforcime në vitin 2023, pas përshkallëzimit të tensioneve në veri të Kosovës, përfshirë sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it dhe sulmin e armatosur në Banjskë. Në një përgjigje për "REL"-in më 20 tetor, një zyrtar i NATO-s ka thënë se misioni kishte rreth 4.600 ushtarë nga vendet anëtare dhe partnere. Sipas tij, ndryshimet do të jenë graduale dhe do të varen nga vlerësimet e sigurisë. Ato mund të pezullohen ose të kthehen mbrapsht, nëse situata në terren e kërkon këtë. Aleanca ka theksuar se mund ta përforcojë KFOR-in nëse rrezikohet siguria në Kosovë ose stabiliteti rajonal.

NATO-ja nuk ka sqaruar se si do të ndikojë riorganizimi në kontingjentin amerikan, por e ka mirëpritur kontributin afatgjatë të ShBA-së dhe angazhimin e trupave të reja amerikane në mision.

A mund ta shtojë Gjermania praninë e saj?

E pyetur nëse do të shqyrtonte dërgimin e më shumë ushtarëve në Kosovë, në rast të një reduktimi amerikan, Ministria gjermane e Mbrojtjes nuk ka dhënë përgjigje të drejtpërdrejtë. "Qeveria gjermane nuk spekulon për vendimet e mundshme të qeverive të tjera", ka thënë zëdhënësi për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka rikujtuar se Parlamenti gjerman, në qershor, e ka zgjatur edhe për një vit mandatin e forcave gjermane në KFOR, duke lejuar dislokimin e deri në 400 ushtarëve.

Shtetet e Bashkuara udhëheqin Komandën Rajonale Lindje të KFOR-it, me seli në kampin Bondsteel, afër Ferizajt. Forcat amerikane janë të pranishme në Kosovë që nga viti 1999, kur NATO-ja dislokoi misionin paqeruajtës pas përfundimit të luftës. KFOR-i vepron në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. NATO-ja ka theksuar se, pavarësisht ndryshimeve të planifikuara, mandati i misionit dhe angazhimi i saj për sigurinë e Kosovës mbeten të pandryshuara.

Konjufca: Republika e Kosovës e ka dëshmuar përkushtimin e saj ndaj integrimit evropian

ATHINË, 23 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, ka marrë pjesë në takimin ministror të Grupit të Miqve të Ballkanit Perëndimor, i organizuar në Athinë nga ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, George Gerapetritis.

Në fjalën e tij, zëvendëskryeministri Konjufca ka theksuar se një proces i besueshëm i zgjerimit të Bashkimit Evropian duhet t'i japë mundësi secilit vend të Ballkanit Perëndimor të përparojë në bazë të meritave dhe reformave të realizuara. Ai ka rikujtuar se kanë kaluar pothuajse katër vjet nga aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE dhe ka bërë thirrje që Këshilli i BE-së t'i kërkojë Komisionit Evropian përgatitjen e Opinionit për aplikimin e Kosovës. Zëvendëskryeministri Konjufca ka theksuar përparimin e Kosovës në reformat demokratike, përputhjen e plotë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (CFSP), si dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në misionet dhe operacionet e Bashkimit Evropian. "Republika e Kosovës e ka dëshmuar përkushtimin e saj ndaj integrimit evropian, si përmes reformave, ashtu edhe përmes qëndrimit të saj të palëkundur në mbështetje të politikave të BE-së. Tani është koha që ky përkushtim të përcillet me hapa konkretë nga BE-ja, duke i mundësuar Kosovës të ecë përpara në procesin e anëtarësimit, njësoj si vendet e tjera të rajonit", ka thënë Konjufca.





SA LARG MUND TË ŞHKOJË DORA E SHTETIT NË HAGË?

Liderët e UÇK-së janë duke u përgatitur ta kundërshtojnë në apel aktgjykimin e shkallës së parë në Hagë. Në këtë proces ata pritet të mbështeten edhe nga institucionet e Kosovës, të cilat kanë nisur hartimin e një strategjie për të kontribuar në përpjekjet e tyre juridike. Ekspertët e së drejtës penale ndërkombëtare kanë vlerësuar se ndihma financiare dhe ekspertiza juridike janë të ligjshme dhe mund të jenë të dobishme, por nuk garantojnë ndryshimin e aktgjykimit. Ata kanë identifikuar çështje që mund të kundërshtohen gjatë procesit të apelit, ndërsa kanë shprehur rezerva për përpjekjet për ta ndryshuar ligjin mbi të cilin funksionon Gjykata Speciale

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Katër udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) janë duke u përgatitur për një tjetër betejë juridike në Hagë, këtë herë për ta kundërshtuar aktgjykimin që i ka dënuar në shkallë të parë me gjithsej 81 vjet burgim për krime lufte. Në këtë përpjekje, ata pritet ta kenë edhe mbështetjen e institucioneve më të larta të Kosovës, të cilat kanë nisur hartimin e një strategjie për t'i ndihmuar gjatë procesit të apelit. Synimi i deklaruar është ndryshimi i aktgjykimit. Por, sa mund të ndikojë një shtet në rezultatin e një procesi gjyqësor? Ku përfundon mbështetja e ligjshme dhe ku fillon ndërhyrja politike? Ekspertët e së drejtës penale ndërkombëtare, me të cilët ka biseduar "Radio Evropa e Lirë", kanë thënë se mbështetja financiare dhe ekspertiza juridike mund të jenë të dobishme, por ndikimi i shtetit në rezultatin përfundimtar mbetet i kufizuar. Ata identifikojnë disa çështje që mund të kundërshtohen në apel, por shprehin rezerva ndaj përpjekjeve për ta ndryshuar ligjin mbi të cilin funksionon Gjykata Speciale.

Një strategji shtetërore, por pak hollësi

Më 16 shtator Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë shpallur fajtorë për krime lufte katër udhëheqësit e UÇK-së: ish-presidentin Hashim Thaçi, ish-kryetarët e Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-deputetin Rexhep Selimi.

Thaçi dhe Krasniqi janë dënuar me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet dhe Selimi me 13 vjet. Ata janë shpallur të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Ekipet mbrojtëse e kanë kundërshtuar aktgjykimin dhe kanë paralajmëruar apelimin e tij. Afati për paraqitjen e njoftimeve të apelit është 27 nëntori.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka formuar një grup punues, të udhëhequr nga zëvendëskryeministri Glauk Konjufca, për të bashkërenduar mbështetjen juridike, institucionale dhe diplomatike gjatë kësaj faze të procesit.

Nisma ka marrë mbështetjen edhe të presidentes Justina Shiroka-Pula, e cila është takuar me grupin punues, është informuar për ecurinë e strategjisë dhe ka përkrahur bashkërendimin e veprimeve institucionale. Megjithatë, përmbajtja konkrete e strategjisë mbetet kryesisht e panjohur.

Konjufca ka bërë me dije se puna e grupit do të zhvillohet në konfidencialitet, për shkak të ndjeshmërisë së çështjeve që trajtohen. "Qëllimi është që ta fitojmë rastin në procesin e apelit", ka deklaruar ai, duke theksuar se diskutimet dhe synimet e grupit janë të ndjeshme si në aspektin vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. "Radio Evropa e Lirë" i ka kërkuar Konjufcës sqarime për mënyrën e funksionimit të grupit dhe mbështetjen që synon të ofrojë, por nuk ka marrë përgjigje. Pa përgjigje kanë mbetur edhe pyetjet drejtuar avokatit të Thaçit, Lluka Mishetiq, lidhur me përgatitjet për apel, argumentet që mund të përdoren dhe rolin e mundshëm të Qeverisë së Kosovës. Në mungesë të këtyre hollësive, mbetet e paqartë se si do të përkthehet angazhimi i institucioneve në ndihmë konkrete për ekipet mbrojtëse.

Ndihmë financiare po, trysni politike jo

Përfshirja e shteteve në mbështetjen e shtetasve apo ish-zyrtarëve të tyre gjatë proceseve penale ndërkombëtare nuk është e pazakontë. Por, ekspertët bëjnë dallim mes ndihmës juridike dhe përpjekjeve për të ndikuar politikisht në një gjykim.

William Schabas, profesor i së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin Middlesex të Londrës, ka thënë se institucionet e Kosovës mund të kontribuojnë financiarisht për të siguruar mbrojtje cilësore juridike. "Nëse Qeveria e Kosovës dëshiron të kontribuojë financiarisht për t'i ndihmuar të pandehurit të angazhojnë ekipet e tyre juridike, kjo nuk do të ishte e pazakontë. Por, nëse synon forma të tjera përfshirjeje, si fushata apo lobim, nuk mendoj se kjo do të ishte e pranueshme", ka thënë Schabas për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë".

Një mbështetje e tillë mund t'u mundësojë ekipeve mbrojtëse të angazhojnë ekspertë, të analizojnë prova dhe të përgatisin argumente për apel. Por, kjo nuk i jep shtetit të drejtën të përcaktojë strategjinë e mbrojtjes apo të ushtrojë ndikim mbi gjyqtarët.

Carsten Stahn, profesor i së Drejtës Penale Ndërkombëtare në Universitetin Leiden të Holandës,, ka thënë se përvoja nga gjykimet e mëparshme ndërkombëtare tregon se ndikimi i shteteve në rezultatet gjyqësore ka qenë i kufizuar. "Sepse, ose keni argumente të forta juridike që mbrojtja mund t'i paraqesë para gjykatës, ose nuk i keni. Dhe nëse nuk i keni, fakti që një shtet ju mbështet, nuk do të thotë se gjykata do ta ndryshojë domosdoshmërisht arsyetimin apo qëndrimin e saj juridik", ka thënë ai për "Expose". Sipas Stahnit, është veçanërisht e rëndësishme që avokatët të ruajnë pavarësinë në përfaqësimin e klientëve të tyre. "Shteti nuk mund të ushtrojë trysni politike mbi mbrojtjen, duke i diktuar asaj se si t'i ndërtojë argumentet juridike. Sepse, detyrimi i avokatëve është ndaj klientëve të tyre dhe kjo nuk mund të ndikohet nga shteti", ka theksuar ai.

Çfarë tregojnë rastet nga Kroacia?

Kufijtë e ndikimit shtetëror janë vënë në provë edhe në procese të tjera për krime lufte në ish-

Jugosllavi. Një prej tyre është rasti i Jadranko Përlliqit dhe pesë ish-zyrtarëve të tjerë politikë e ushtarakë të kroatëve të Bosnjës, të gjykuar nga Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Në aktgjykim përfshiheshin edhe konstatime për rolin e zyrtarëve të lartë të Kroacisë, mes tyre, presidentit të atëhershëm, Franjo Tugjman, në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.

Ndonëse këta zyrtarë nuk ishin të pandehur, konstatimet kishin rëndësi politike dhe historike për Kroacinë. Për këtë arsye, Zagrebi kishte kërkuar të ndërhynte në procedurën e apelit, për t'i kundërshtuar gjetjet që lidheshin me shtetin kroat.

Por, Tribunali ia kishte refuzuar kërkesën, duke theksuar se procesi kishte për objekt përgjegjësinë penale të individëve, jo të shtetit. Situata e Kosovës është ndryshe, pasi institucionet e saj nuk kanë paralajmëruar ndonjë kërkesë për t'u bërë palë në procedurën e apelit, por një strategji për mbështetjen e të dënuarve. Megjithatë, për Stahnin, ky rast ilustron kufijtë e ndikimit që mund të ketë një shtet në një proces gjyqësor. Përvoja kroate ofron edhe një shembull tjetër, me rezultat krejtësisht të ndryshëm. Gjenerali Ante Gotovina ishte dënuar fillimisht me 24 vjet burgim për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, të lidhura me operacionin ushtarak "Stuhia" të vitit 1995. Por, në vitin 2012, Dhoma e Apelit e Tribunalit e ka përmbysur dënimin dhe e ka shpallur të pafajshëm. Në mbrojtjen e tij ishin angazhuar edhe ekspertë juridikë dhe ushtarakë.

Mathias Holvoet, ligjërues i së Drejtës Penale Ndërkombëtare në Universitetin e Amsterdamit, e sjell këtë rast si shembull të rëndësisë që mund të ketë ekspertiza e specializuar gjatë apelimit të një aktgjykimi kompleks. "Nëse do t'i këshilloja institucionet e Kosovës, do t'u thosha të angazhojnë ekspertët më të mirë në fusha të ndryshme juridike. Për shembull, për ndërmarrjen e përbashkët kriminale, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, por edhe ekspertë të provave, që mund të vlerësojnë nëse ato i përmbushin standardet e nevojshme për një dënim", ka thënë Holvoet për "Expose". Rezultati i rastit Gotovina, megjithatë, nuk garanton një përfundim të ngjashëm në procesin kundër katër ish-krerëve të UÇK-së.

Çdo apel shqyrtohet mbi bazën e aktgjykimit përkatës dhe gabimeve të pretenduara në zbatimin e ligjit apo në vlerësimin e fakteve.

Ku mund të sfidohet aktgjykimi?

Përtej angazhimit të institucioneve, çështja vendimtare për fatin e katër të dënuarve është se cilat pjesë të aktgjykimit mund të kundërshtohen me sukses. Ekspertët e intervistuar nga "Radio Evropa e Lirë" kanë identifikuar dy fusha ku mund të përqendrohet beteja juridike: përgjegjësinë përmes ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe bazën ligjore për përcaktimin e dënimeve.

Ndërmarrja e përbashkët kriminale është një koncept i së drejtës penale ndërkombëtare, sipas të cilit një person mund të mbajë përgjegjësi penale edhe për krime që nuk i ka kryer drejtpërdrejt, nëse vërtetohet pjesëmarrja e tij në një qëllim të përbashkët kriminal dhe plotësohen kushtet e tjera juridike. Pikërisht mbi këtë koncept është mbështetur gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë penale të katër ish-udhëheqësve të UÇK-së. Sipas Holvoetit, një prej çështjeve që mbrojtja mund të sfidojë është nëse provat e paraqitura gjatë gjykimit e mbështesin mjaftueshëm përfundimin për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal dhe lidhjen e të dënuarve me të. "Është e qartë se janë kryer krime, por çështja kryesore është lidhja e tyre me ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Pikërisht mbi këtë bazë do të përpiqesha ta kundërshtoja aktgjykimin, pra nëse ka ekzistuar një qëllim i përbashkët. Sepse, për një ndërmarrje të përbashkët kriminale, duhet të ekzistojë një qëllim i tillë", ka thënë ai.

Në praktikë, mbrojtja do të duhej të identifikonte gabime konkrete në arsyetimin juridik apo në vlerësimin e provave, të cilat mund të kenë ndikuar në përfundimin e trupit gjykues.

Edhe Stahn sheh hapësirë për argumente rreth interpretimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, por veçon edhe një çështje tjetër: mënyrën se si janë përcaktuar dënimet. "Çështja e dytë është mënyra se si gjyqtarët i kanë përcaktuar dënimet dhe cili ligj duhet të shërbejë si bazë për to. A kanë të pandehurit të drejtë të dënohen sipas ligjit që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprave, apo përparësi ka korniza ligjore e Dhomave të Specializuara?", ka pyetur ai.

Kjo çështje lidhet me një parim themelor të së drejtës penale: ligjshmërinë e dënimit dhe zbatimin e dispozitave penale në kohë. Argumentet mbi ligjin e zbatueshëm dhe masën e dënimit mund të jenë të rëndësishme për mbrojtjen edhe nëse Dhoma e Apelit nuk e ndryshon përfundimin për fajësinë. Megjithatë, mbetet të shihet se cilat argumente konkrete do t'i paraqesin ekipet mbrojtëse dhe si do t'i vlerësojnë ato gjyqtarët.

Haxhiu dhe Çitaku: Nisma e re për Ligjin për Specialen do të procedohet brenda kësaj jave



Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka bërë të ditur se nisma e re lidhur me Ligjin për Dhomat e Specializuara do të procedohet brenda kësaj jave. Ajo ka thënë se çështja është përballur me pengesa procedurale dhe jopërmbajtjesore. Haxhiu ka paralajmëruar se këto pengesa procedurale pritet të tejkalohen dhe se do të hartohet një draft i ri lidhur me vendimin e Dhomave të Specializuara, të cilin ajo e ka cilësuar si të padrejtë. "Sa i përket Ligjit për Specialen, ne si Kryesi e Kuvendit kërkuam një opinion, raport lidhur me veprimet e radhës, sepse sipas Rregullores, Komisioni përkatës i ka katër javë për ta proceduar raportin në seancën plenare. Nga Drejtoria Ligjore kemi kërkuar se çfarë ndodh në rrethanat kur ky afat kalohet. Sipas informacioneve që kam, një nismë e re do të procedohet brenda kësaj jave. Më duhet të theksoj se nuk kemi pasur një problem përmbajtjesor, çështjet kanë qenë komplet procedurale. Ato besoj se tashmë do të tejkalohen dhe do të ketë një draft të ri lidhur me çështjen e vendimit të padrejtë të Speciales", ka deklaruar Haxhiu.

Edhe ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së dhe nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vlora Çitaku, ka thënë se brenda kësaj jave do të procedohet në Kuvend nisma e re ligjore për Dhomat e Specializuara. "Dua t'ju njoftoj se brenda kësaj jave do të procedojmë në Kuvendin e Kosovës nismën e re ligjore për Dhomat e Specializuara. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që kjo nismë gëzon unitetin e plotë politik dhe qytetar. Kjo nismë nuk është vetëm e PDK-së, por ka vulën e institucioneve të Kosovës", ka thënë Çitaku.

Çitaku ka shtuar se do të jenë të hapur për bashkëpunim gjatë punës që do të zhvillohet në komisionet përkatëse të Kuvendit. Ajo ka përsëritur se kjo nismë ligjore do të jetë vetëm njëri nga elementet që do të përdoren për betejën e krerëve të UÇK-së në Hagë. "Synimi ynë është që, shumë shpejt, brenda një afati sa më të shkurtër, ky ligj të kalojë në të dy leximet", ka thënë ajo. Ajo ka shtuar se PDK-ja dhe LV-ja janë kundërshtare politike dhe kanë mospajtime të thella ndërmjet vete, por, sipas saj, këto dy parti i bashkon vlera e UÇK-së.

Nga ndryshimet ligjore te një nismë e re

Ndërsa mbrojtja përgatitet ta sfidojë aktgjykimin në Hagë, në Prishtinë po zhvillohet edhe një përpjekje tjetër, që synon ndryshimin e kornizës ligjore mbi të cilën funksionon Gjykata Speciale.

Por, kjo nismë, e përcjellë me mospajtime politike dhe kundërshtime ndërkombëtare, ka marrë një drejtim të ri. Më 19 nëntor, kryeministri Albin Kurti dhe ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, janë pajtuar që ndryshimet të procedohen përmes një projektligji të ri, në vend që të votohet sërish teksti i miratuar nga Kuvendi më 6 tetor. Marrëveshja ka ardhur pas disa javësh paqartësish rreth ligjit, të cilin presidentja Justina Shiroka-Pula e kishte kthyer për rishqyrtim më 22 tetor, me kërkesë të vetë PDK-së, që e kishte iniciuar atë. Ndryshimet e miratuara në tetor parashihnin, ndër të tjera, kufizimin e juridiksionit të Gjykatës, ngushtimin e periudhës kohore dhe territorit për të cilin ajo mund të gjykojë, si dhe uljen e dënimit maksimal me burgim në 15 vjet. Ato përfshinin edhe mundësinë e vuajtjes së dënimeve në Kosovë.

Kurti ka paralajmëruar se drafti i parë i projektligjit të ri pritet të përgatitet nga një ekip ekspertësh gjatë javës së ardhshme, ndërsa Çitaku ka thënë se synimi është që ai të jetë juridikisht më i qëndrueshëm dhe më i zbatueshëm. Por, përtej dakordimit mes tyre, mbetet e paqartë nëse ndryshimet ligjore mund të ndikojnë në procesin gjyqësor në Hagë.

Ekspertët e intervistuar nga "Radio Evropa e Lirë" kanë shprehur rezerva për përpjekjet që synojnë kufizimin e kompetencave të Gjykatës.

Stahn ka paralajmëruar se ndryshimet e njëanshme të juridiksionit të saj mund të dëmtojnë perceptimin për sundimin e ligjit në Kosovë.

Schabas, në anën tjetër, ka vlerësuar se nisma mund të ketë pasoja juridike dhe diplomatike, pa sjellë domosdoshmërisht ndonjë përfitim për katër të dënuarit. Sipas tij, përpjekjet për ndryshimin e ligjit duket se u shërbejnë më shumë qëllimeve të politikës së brendshme sesa një rezultati konkret juridik. Ai ka rikujtuar se të dënuarit mbeten nën autoritetin e Gjykatës në Hagë, pavarësisht vendimeve që mund të merren në Prishtinë. "Të burgosurit janë nën kontrollin e Gjykatës dhe Kosova nuk ka mundësi ta ndryshojë këtë", ka thënë Schabas.

Kush do ta kishte fjalën e fundit?

Dhomat e Specializuara janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por funksionojnë në Hagë, me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Ato janë themeluar në bazë të ndryshimeve kushtetuese dhe një ligji të veçantë, në kuadër të zotimeve ndërkombëtare që ka marrë Kosova. Kjo strukturë e pazakontë ngre dilema për mënyrën se si do të trajtoheshin ndryshimet ligjore nëse ato do të kontestoheshin. A do ta kishte fjalën e fundit Gjykata Kushtetuese në Prishtinë apo Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në Hagë? Dhe, nëse një ligj i ri do të hynte në fuqi, a do të mund të zbatohej edhe ndaj aktgjykimeve të shpallura para miratimit të tij? Ekspertët e intervistuar nga "Radio Evropa e Lirë" nuk japin përgjigje të prera për këto çështje. As Dhomat e Specializuara nuk i janë përgjigjur kërkesës së "Radios Evropa e Lirë" për sqarime. Përderisa përmbajtja e projektligjit të ri ende nuk dihet, mbetet e paqartë edhe nëse ai mund të ketë ndonjë efekt praktik në procesin e apelit.

Ligji për Specialen, Kurti: Presim që ekspertët ta përmbyllin draftin këto ditë

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se është në pritje që ekspertët ta përfundojnë draftin e ri të Ligjit për Dhomat e Specializuara. Drafti i ri i kësaj nisme do të hartohet pas dakordimit të arritur javën e kaluar ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës. Pikërisht për shkak të këtij pajtimi ishte shtyrë edhe seanca e Kuvendit të Kosovës, në të cilën kjo nismë ligjore ishte paraparë si pikë e rendit të ditës. "Gjatë kësaj jave kemi thënë dhe po presim prej ekspertëve që ta përmbyllin këto ditë", ka thënë Kurti të hënën, pas ceremonisë solemne të shënimit të 27-vjetorit të themelimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



SHKK-ja SHËNON 27-VJETORIN, HAXHIU DHE KURTI VLERËSOJNË RËNDËSINË E SIGURISË DHE REHABILITIMIT TË TË BURGOSURVE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë, zbatimin e ligjit dhe forcimin e sundimit të ligjit, por po aq i rëndësishëm është edhe rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të privuar nga liria, ka thënë kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, në ceremoninë e shënimit të 27-vjetorit të themelimit të këtij institucioni. Haxhiu ka vlerësuar se funksionimi i Shërbimit Korrektues mbështetet në punën dhe përkushtimin e zyrtarëve që shërbejnë në këtë institucion. "Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk është vetëm një institucion që administron vuajtjen e dënimit; ai është një institucion që garanton sigurinë, mbron rendin, zbaton ligjin dhe kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Por, mbi të gjitha, ky institucion qëndron dhe funksionon falë njerëzve që çdo ditë i shërbejnë atij me përgjegjësi, me profesionalizëm dhe me përkushtim", ka thënë ajo.

Ajo ka theksuar se suksesi i një sistemi korrektues nuk duhet të matet vetëm me administrimin e dënimeve, por edhe me mundësitë që u ofrohen të burgosurve për ndryshim dhe rikthim në shoqëri. "Një përgjegjësi po aq e rëndësishme është kontributi në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të privuar nga liria, sepse sot një sistem korrektues i suksesshëm nuk matet vetëm me aftësinë për të administruar dënimin, por edhe me mundësinë që u jep njerëzve të ndryshojnë, të përgatiten për një jetë të re dhe të rikthehen si qytetarë të përgjegjshëm në shoqërinë tonë", ka thënë ajo.

Kurti: Burgu është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë

Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se burgu është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë, ndërsa ka theksuar se të drejtat e personave të privuar nga liria duhet të respektohen nga të gjithë. "Natyrisht që burgu nuk është i mirë, por është i domosdoshëm për ta mbrojtur shoqërinë. I burgosuri apo i paraburgosuri e humbet lirinë, por asnjëherë të drejtën. Të cilat mbrohen e respektohen nga të gjithë ne bashkë dhe nga secili prej jush, pavarësisht nga funksioni që përfaqëson. Ky progres i madh i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Kosovës është dëshmuar edhe përmes vlerësimeve të çmuara", ka thënë Kurti.

Kreu i qeverisë ka vlerësuar përparimin e Shërbimit Korrektues gjatë 27 vjetëve, veçanërisht në profesionalizimin e stafit, avancimin e legjislacionit, modernizimin e infrastrukturës dhe zgjerimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrimit. "Ky përvjetor është një mundësi për të nderuar rrugëtimin e këtij institucioni dhe për të vlerësuar të gjithë ata që për 27 vjet rresht kanë kontribuar në ndërtimin dhe zhvillimin e tij. Gjatë këtyre viteve shërbimet korrektuese të Kosovës kanë shënuar përparim të rëndësishëm në profesionalizimin e stafit, avancimin e legjislacionit,



modernizimin e infrastrukturës, forcimin e sigurisë dhe zgjerimin e programeve të rehabilitimit dhe të riintegrimit", ka shtuar ai.

Kurse zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka vlerësuar profesionalizmin dhe integritetin e Shërbimit Korrektues, duke theksuar se sistemi i burgjeve në Kosovë është në përputhje me standardet ndërkombëtare për trajtimin e personave të privuar nga liria. Ajo i është referuar edhe Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, sipas të cilit, Kosova ofron garanci ligjore për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit. "Shërbimi Korrektues vërtet ka dëshmuar profesionalizëm, përkushtim dhe integritet, transformim i vazhdueshëm i infrastrukturës, rritje e numrit dhe cilësisë së zyrtarëve korrektues, si dhe përparim me standarde bashkëkohore korrektuese. Në raportin e sivjetshëm të progresit të Komisionit Evropian theksohet se Kosova ofron garanci të duhura ligjore për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit, sistemi i burgjeve në përgjithësi është në përputhje me rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e burgosurve, ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale ndalon diskriminimin mbi çfarëdo baze, përfshirë aftësinë e kufizuar, dhe kërkon që të gjithë të burgosurit të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe me respekt të plotë për dinjitetin e tyre. Ligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës, së bashku me të gjitha aktet nënligjore përcjellëse, të cilat janë në përputhje edhe me legjislacionin e BE-së, është baza e punës sonë të përditshme", ka potencuar ajo.

Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, ka thënë se gjatë viteve të fundit institucioni ka avancuar në aspektin ligjor, profesional dhe të sigurisë, me synimin për t'u përafruar me sistemet më të zhvilluara evropiane. Ai ka bërë me dije se ShKK-ja është fuqizuar me mbi 400 zyrtarë të rinj, ndërsa qindra të tjerë janë trajnuar brenda dhe jashtë vendit. "Gjatë viteve të fundit kemi punuar me një vizion të qartë: ndërtimin e një shërbimi korrektues modern, profesional dhe të krahasueshëm me sistemet më të zhvilluara evropiane. Kemi avancuar kornizën ligjore përmes nxjerrjes së ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndryshimit të ligjeve kryesore dhe miratimit të rreth 30 akteve nënligjore. Kemi investuar në ngritjen profesionale të stafit, me qindra zyrtarë të trajnuar brenda dhe jashtë vendit, si dhe kemi fuqizuar institucionin me mbi 400 zyrtarë të rinj", ka thënë ai.

Dibrani ka theksuar se mbi 5 000 persona të privuar nga liria janë përfshirë në programe edukative, profesionale dhe rehabilituese, ndërsa janë bërë investime në infrastrukturë, teknologji dhe sistemin e sigurisë. "Kemi themeluar institucionin për trajtimin e personave me nevoja të veçanta, kemi modernizuar infrastrukturën, kemi investuar në teknologji dhe kemi avancuar sistemin e sigurisë. Mbi 5 000 persona të privuar nga liria janë përfshirë në programe edukative, profesionale dhe rehabilituese. Kemi nënshkruar me dhjetëra marrëveshje bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, duke krijuar mundësi të reja për arsim dhe përgatitje për rikthim në shoqëri. Këtu nuk janë vetëm statistika. Janë parandaluar dhe zbuluar rreth 600 raste të reja të parandalimit të kontrabandës", ka thënë Dibrani.

HARADINAJ PARA NXËNËSVE NË DEÇAN FLET PËR HISTORINË, SAKRIFICËN E UÇK-së DHE RRUGËTIMIN DREJT LIRISË

DEÇAN, 23 NËNTOR - Në prag të festave kombëtare të nëntorit, ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" në Deçan, ku ka zhvilluar një bashkëbisedim me nxënësit për historinë dhe rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe shtetndërtimit.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, Haradinaj ka bërë me dije se gjatë takimit kanë diskutuar për përpjekjet ndër breza, të cilat, sipas tij, janë kurorëzuar falë sakrificës së djemve dhe vajzave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe mbështetjes së aleatëve ndërkombëtarë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye. "Në prag të festave kombëtare të Nëntorit, sot pata nderin që së bashku me nxënësit e Gjimnazit 'Vëllezërit Frashëri' në Deçan, të bashkëbisedoj hapur për të vërtetën tonë historike dhe përpjekjet ndër breza deri te liria dhe shtetndërtimi, të cilat u kurorëzuan falë sakrificës së djemve dhe vajzave të UÇK-së, si dhe ndihmës së aleatëve tanë, në krye me ShBA-në. Po ashtu, shfrytëzova rastin që ta falënderoj drejtorin Hamid Qorraj, menaxhmentin dhe arsimtarët për punën e tyre në shërbim të edukimit të brezave të rinj. Gjatë vizitës pata kënaqësinë të shoh nga afër edhe ekspozitën dhe kabinetet e shkollës", ka theksuar Haradinaj.



DINJITETI I SHEMBUR



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA

Nekrofilët e demokracisë: Jakup Krasniqi, për shkak të angazhimit kombëtar, u përndoq dhe u dënua nga dy regjime antidemokratike dhe raciste nga regjimi jugosllav dhe regjimi racist i Gjykatës Speciale Raciste (GjSR). Është vështirë të thuhet se cili regjim ishte më kriminal, ai jugosllav apo ky i "drejtësisë ndërkombëtare". Kur u arrestua Jakup Krasniqi më 4 nëntor 2020 në Prishtinë nga piratët e GjSR-së, në paraqitjen e tij para gjykatës pati deklaruar se: "sjellja e piratëve të maskuar me uniforma policie, pa shenja identifikimi ishte më e keqe dhe më e dhunshme se sjellja e policisë jugosllave gjatë arrestimit të parë në ish-Jugosllavi...". Askush nuk e mori seriozisht këtë deklaratë në kohën kur GjSR-ja në Hagë mburrej se në këtë burg zbatohen standardet më të larta të Kombeve të Bashkuara të drejtave të njeriut për të privuar nga liria të quajtura "Rregullat e Nelson Mandelës...". Trajtimi në vazhdimësi i keq dhe diskriminues i pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës nga kjo gjykatë raciste është shkelje flagrante e të drejtave të njeriut dhe shpërdorim i turpshëm i emrit të një personaliteti që ishte shembull i sakrificës personale të luftës për liri dhe barazi të popujve të robëruar të botës - Nelson Mandelës. Shkelësit kriminalë të drejtave të njeriut, kriminelët juridikë, Ekaterina Trandafilova, Kim West, Charles Smith III dhe të tjerët po mbulohen me emrin dhe veprat e Mandelës, pa fije turpi dhe ndërgjegjeje. Tipike për kriminelë! Të ashtuquajtura vizita humanitare për të burgosurit shqiptarë janë përdorur më shumë për nevoja të gjykatës dhe jo të të burgosurve. Çfarë kuptimi dhe çfarë humanizmi është t'u mohohet pjesëmarrja në varrim të më të dashurve e që pastaj t'u mundësohet vizita e varrit ?! Çnjerëzore dhe sadiste edhe për kriminelët më të poshtër, por jo edhe për kriminelët e GjRS -së që këtë e kanë kod moral dhe profesional!

"Vizita humanitare" e Jakup Krasniqit: Jakup Krasniqi nga GjRS-ja u dënua me dënimin maksimal prej 25 vjetësh, non sens i llojit të vet. Jugosllavia fashiste e nisi përndjekjen e atdhetarit, luftëtarit të UÇK-së, politikanit shtetformues dhe paqendërtues si dhe intelektualit Jakup Krasniqi, tash, GjSR-ja, si vazhdimësi gjenetike dhe politike e Serbisë po e përfundon këtë krim njerëzorë, moral dhe profesional duke e dënuar me 25 vjet burgim dhe diskriminim, në emër të "humanizmit" dhe "Rregullave të Nelson Mandelës...". Nënat tona, gratë tona dhe motrat tona janë më heroina se ne që kemi bërë burg politik në kohën e Jugosllavisë fashiste dhe drejtësisë ndërkombëtare raciste. Vuajtjet e vërteta i bartnin ato, pa asnjë dyshim. E tillë ishte dhe është gruaja e Jakup Krasniqit, në rastin konkret. Tash, kur shëndeti i saj është rrënuar shumë edhe si pasojë e trajtimit të Jakup Krasniqit, GjSR-ja i mundësoi një vizitë "humanitare" pengut të dënuar, Jakup Krasniqi në kushte turpëruese dhe nën çdo dinjitet. Vizitat e Jakup Krasniqit, tashmë i dënuar ishin rreptësisht të mbikëqyrura, jashtë dhe brenda shtëpisë. Sikur të ishte gjendje lufte. Nuk e lejuan të përshëndetet me vëllanë, brenda dhomës ku ishte Jakup Krasniqi me familje kishte policë cuba të GjSR-së me rroba civile që kontrollonin çdo lëvizje, sigurisht se kanë regjistruar çdo bisedë dhe jam i sigurt se kanë folur dhe kuptuar gjuhën shqipe. Jakup Krasniqi qëndronte 6-7 orë në takim me familjarë dhe me banditët e GjSR-së në të njëjtën hapësirë kurse natën e kalonte në burgun e EULESH -it në F. Kosovë. Në asnjë shtet dhe vend normal nuk trajtohen njëjtë ata që mbahen në paraburgim dhe ata që janë dënuar. "Drejtësia" ndërkombëtare, duke dhunuar emrin dhe veprën e Nelson Mandelës e bënë këtë, kryesisht kundër pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Me ndihmën e "xhandarëve të Xhelës", Albin Kurthit, Albulena Haxhiut, Glauk Konjufcës, Shvarc Donikës dhe pjellës jugosllave dhe serbe të aziluar në institucione të Kosovës. Opozita u mjaftua me deklarata politike dhe emocionale - flluska patriotike (PDK), AAK ishte më korrekte, kurse LDK-ja përmes Vojsa Osmanit dhe Lubo-mirit po e "lufton" ShIK-un, për lavdi të respektit dhe nderimit ndaj UDB-së! Në këto zhvillime Shoqata e të Burgosurve Politikë (edhe unë jam njëfarë i burgosuri politikë) dhe Shoqata e Veteranëve të Luftës do të duhej të ishin shtylla të çdo veprimi - nuk janë ! ShBP-ja po mbahet në jetë për fije të perit e shantazhuar nga regjimi i Kurthit, thuaja është buzë vdekjes klinike! ShVL e UÇK-së po merret me tema të rëndësisë globale duke u takuar me diplomatë duke bërë "diplomaci ushtarake...!". Janë shumë larg realitetit!



E tash, lexues të nderuar, merreni me mend se kush po e harton Strategjinë për "mbrojtje" të pengjeve të luftës, tash të dënuar në Hagë! Kur mindilin e kësaj valleje e ka marrë Albin Kurthi armik dhe denoncues i Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit. Me përcjellësit me përmbajtje të njëjtë, mediokër dhe rrogëtarë të bindur, Glauku, Lenka Quko, Xhelë xhandari dhe Shvarc Donika! Dhe me disa biseksualë politikë në PDK.

Çfarë ligji i leshit! Duhet të derdhen para për mbrojtje, lobim dhe duhet rifilluar protestat. Të gjitha të tjerat janë humbje kohe nga o-pozita dhe blerje kohe nga Kurthi. Aktualisht PDK-ja po punon kryesisht për Kurthin, prandaj LV po luan tjetër lojë - kundër Përparim Ramës!

Jakup Krasniqi nuk është turpëruar e as ligështuar sepse është në mesin e të turpëruarve, të ligjeve dhe të dorëzuarve. Ata jemi ne!

PROMOVOHET "LIBRI I LIRISË – GJURMË NË KOHË VENDIMTARE" I GAZETARIT NUHI BYTYÇI

Prishtinë, 23 nëntor - Gazetari Nuhi Bytyçi ka promovuar të hënën librin "Libri i lirisë - gjurmë në kohë vendimtare", në një aktivitet të mbajtur në "Kino Armata", ku kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve, personalitete akademike, profesorë dhe familjarë të personaliteteve të historisë së Kosovës. Në promovimin e librit kanë marrë pjesë edhe protagonistë të luftës së UÇK-së, përfshirë gjeneralin Kudusi Lama, Nait Hasanin, Ramë Bujën dhe Kadri Kastratin. Po ashtu, në këtë aktivitet kanë qenë të pranishëm edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda dhe Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit. Në fillim të promovimit është shfaqur një dokumentar, i cili ka përmbledhur përmbajtjen e librit dhe materialet që gazetari Bytyçi ka dokumentuar ndër vite. Profesori Astrit Salihu, duke folur për librin në cilësinë e recensentit, ka thënë se ai është një kronikë e përmbledhur e ngjarjeve që autori i ka trajtuar përmes raportimeve televizive, dokumentarëve dhe shkrimeve të publikuara. Kurse profesori Bajram Kosumi, në cilësinë e recensentit të "Libri i lirisë", ka theksuar se, pavarësisht se liria është sfondi tematik i librit, struktura e tij përfshin një mozaik të gjerë temash që nga viti 1989. Në promovimin e "Libri i lirisë" ka folur edhe gazetarja nga Tirana, Marina Zela, e cila ka vlerësuar rëndësinë e librit në dokumentimin e ngjarjeve dhe dëshmive që nuk kanë arritur të regjistrohen përmes fotografive apo incizimeve audio.





Ndërsa autori i librit, gazetari Nuhi Bytyçi, ka bërë me dije se ai është shkruar gjatë luftës për liri, në kohë të vështira dhe vendimtare për Kosovën, duke theksuar se në të pasqyrohen zëri dhe sakrifica e qytetarëve të Kosovës. "'Libri i lirisë' është shkruar gjatë luftës për liri dhe në rrethanat e mungesës së lirisë", ka thënë Bytyçi. Në këtë kontekst, ai ka thënë se UÇK-ja ka qenë projekti më i madh për arritjen e lirisë. "Projekti më i madh për arritjen e lirisë ka qenë UÇK-ja", ka thënë autori Bytyçi.

"Libri i lirisë - gjurmë në kohë vendimtare" sjell një përmbledhje të materialeve publicistike, raportimeve, intervistave, dokumentarëve dhe kronikave televizive të gazetarit Nuhi Bytyçi, të cilat pasqyrojnë periudha dhe ngjarje të rëndësishme në historinë e Kosovës dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri. Në këtë libër është përfshirë edhe dëshmia e Nuhi Bytyçit në Gjykatën Speciale, në mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së.

Nis zbatimi i Sistemit të Pagesave të Shpejta TIPS-K, realizohen me sukses edhe transferet e para të menjëhershme

Prishtinë, 23 nëntor - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se, sipas planit, ka filluar funksionimi i Sistemit të Pagesave të Shpejta të Kosovës (TIPS-K), duke mundësuar kështu realizimin e transfereve të para të menjëhershme për qytetarët dhe bizneset. Në fazën e parë shërbimi po ofrohet nga katër prej dhjetë bankave që operojnë në Kosovë: "ProCredit Bank", "Banka për Biznes" (BPB), "Raiffeisen Bank" dhe "NLB Banka".

Klientët e këtyre bankave mund të kryejnë transfere të shpejta mes vete, deri në 3 000 euro për transfer, në rastet kur banka e dërguesit dhe ajo e pranuesit janë të dyja pjesëmarrëse në TIPS-K.

Transferet realizohen brenda pak sekondash, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, përfshirë fundjavat dhe festat zyrtare, përmes llogarive ekzistuese dhe kanaleve digjitale të bankave (mobile banking/e-banking).

BQK-ja u ka bërë thirrje klientëve që, para nisjes së çdo transferi, t'i kontrollojnë të dhënat para konfirmimit, përfshirë emrin, mbiemrin, IBAN-in dhe shumën. Gjithashtu, ka kërkuar që të kenë kujdes dhe të mos ia japin askujt të dhënat e sigurisë ose të dhëna të tjera të ndjeshme. Transferet në rastet kur njëra nga bankat ende nuk është lidhur me TIPS-K, si dhe ato që tejkalojnë kufirin e përcaktuar për këtë fazë, do të vazhdojnë të procesohen përmes kanaleve ekzistuese të pagesave. Bankat e tjera do t'i bashkohen sistemit gradualisht dhe në vijimësi, pas përfundimit të përgatitjeve të nevojshme teknike dhe operative, brenda periudhës kalimtare tremujore, e cila përfundon më 23 shkurt 2027. BQK-ja ka bërë me dije se në bashkëpunim me bankat pjesëmarrëse po monitoron në vazhdimësi funksionimin e sistemit dhe procesin e integrimit gradual të bankave të tjera. Çdo çështje eventuale teknike ose operative do të trajtohet në koordinim ndërmjet BQK-së dhe bankave pjesëmarrëse dhe, sipas nevojës,



me Bankën e Italisë, me qëllim të sigurimit të funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të shërbimit gjatë fazës së parë të zbatimit.

Në rast se një transferim i shpejtë nuk konfirmohet menjëherë, klientët rekomandohen ta verifikojnë statusin e tij në aplikacionin e bankës ose ta kontaktojnë bankën e tyre para se ta përsërisin transferimin. Lista e përditësuar e bankave pjesëmarrëse, tarifat, përgjigjet në pyetjet më të shpeshta dhe informacionet për funksionimin e TIPS-K janë në dispozicion në faqen zyrtare të BQK-së, në seksionin e dedikuar për këtë sistem. Sistemi i Pagesave të Shpejta të Kosovës (TIPS-K) është lansuar për bankat më 20 nëntor 2026, në një ceremoni zyrtare të organizuar nga BQK-ja. Ndërkaq, me rastin e fillimit të funksionimit të tij, TIPS Clone, si projekt rajonal, do të inaugurohet edhe në një ceremoni zyrtare në Romë, në Bankën e Italisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë nga BQK-ja. Ceremonia do të transmetohet edhe përmes kanaleve zyrtare të BQK-së.

SHPENZIMET PËR SKEMAT E MIRËQENIES SOCIALE NË KOSOVË ARRIJNË NË MBI 82.8 MILIONË EURO GJATË TETORIT

Prishtinë, 23 nëntor - Shpenzimet për skemat e mirëqenies sociale në Kosovë kanë arritur në mbi 82.8 milionë euro gjatë muajit tetor 2026, rreth 387 mijë euro më shumë sesa në shtator. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë rritje të numrit të pensionistëve bazikë dhe të përfituesve të shtesave për fëmijë, ndërsa rënie të numrit të familjeve që marrin ndihmë sociale.

Në muajin tetor 2026, për skemat e mirëqenies sociale janë ndarë gjithsej 82 milionë e 876 mijë e 4 euro, ndërsa në shtator kjo shumë ishte 82 milionë e 489 mijë e 62 euro. Krahasuar me muajin paraprak, shpenzimet janë rritur për 386 mijë e 942 euro. Përkundër rritjes së shumës së përgjithshme të ndarë, numri i përfituesve ka shënuar lëvizje të ndryshme nga një kategori në



tjetrën. Numri i përfituesve të pensionit bazik të moshës është rritur nga 172 721 në shtator në 174 399 në tetor, apo 1 678 përfitues më shumë. Për këtë kategori, në tetor janë ndarë 27 milionë e 781 mijë e 920 euro, krahasuar me 27 milionë e 614 mijë e 160 euro në shtator. Rritje është regjistruar edhe te shtesat për fëmijë, skema me numrin më të madh të përfituesve. Në shtator ishin 374 652 përfitues, ndërsa në tetor ky numër ka arritur në 375 185, apo 533 më shumë. Për këtë skemë janë ndarë mbi 13.5 milionë euro. Në anën tjetër, Skema e Ndihmës Sociale ka shënuar rënie. Nga 14 664 familje përfituese në shtator, numri ka zbritur në 14 444 në tetor, që përfaqëson 220 familje më pak. Edhe shuma e mjeteve të ndara ka rënë, nga 2 milionë e 172 mijë e 544 euro në 2 milionë e 135 mijë e 692 euro.

Rënie e theksuar te familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara

Një nga ndryshimet më të mëdha ndërmjet dy muajve vërehet te skema e përkrahjes financiare për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara. Në shtator kjo kategori kishte 9 394 përfitues, ndërsa në tetor numri ka rënë në 4 565, pra 4 829 përfitues më pak. Megjithatë, kjo rënie e numrit të përfituesve nuk tregon vetvetiu arsyet e ndryshimit dhe as nuk nënkupton domosdoshmërisht se ka rënë numri i familjeve që kanë nevojë për këtë mbështetje. Ndryshime të vogla janë regjistruar edhe te kategoritë e dala nga lufta. Numri i veteranëve të luftës është rritur nga 39 699 në shtator në 39 777 në tetor. Për ta janë ndarë 7 milionë e 846 mijë e 468 euro. Ndërkaq, numri i pensionistëve kontributpagues të moshës ka shënuar një rënie të lehtë, nga 47 738 në 47 654 përfitues.

Më shumë përfituese lehona

Rritje është vërejtur edhe te skemat e mbështetjes financiare për lehonat. Numri i lehonave të punësuara përfituese është rritur nga 2 176 në shtator në 2 231 në tetor, ndërsa te lehonat e papunësuara nga 6 817 në 7 053. Për lehonat e punësuara janë ndarë 1 milion e 118 mijë e 500 euro, ndërsa për ato të papunësuara 3 milionë e 546 mijë e 325 euro.

Vazhdon trendi i ndryshimeve në skemat sociale

Ndryshimet e regjistruara në tetor vijnë pas raportimit për muajin shtator, kur vëmendje të veçantë kishte marrë rritja e numrit të pensionistëve dhe rënia e numrit të familjeve përfituese nga ndihma sociale, krahasuar me shtatorin e vitit 2025. Siç ishte raportuar edhe më herët, gjatë shtatorit 2026, Skema e Ndihmës Sociale kishte 14 664 familje përfituese, krahasuar me 16 474 në shtator të vitit 2025, apo 1 810 familje më pak.

Bizneset kërkojnë mbështetjen e qeverisë përballë reduktimeve të rrymës dhe shtrenjtimit të prodhimit

Prishtinë, 23 nëntor - Bizneset prodhuese në Kosovë po përballen me reduktime të shpeshta të energjisë elektrike dhe rritje të kostove të prodhimit, të cilat po ndikojnë në proceset e punës, po shkaktojnë humbje dhe po vështirësojnë konkurrueshmërinë e tyre në treg.

Përfaqësues të kompanive prodhuese kanë ngritur këto shqetësime, duke kërkuar mbështetje institucionale përmes investimeve në energji solare dhe lehtësimeve për prodhuesit.

Kadir Bajrami, menaxher i prodhimit në kompaninë "Hit Flores", e cila merret me grumbullimin dhe përpunimin e frutave malore, bimëve mjekësore dhe frutave, ka thënë për "Ekonomia Online" se kompania operon kryesisht në tregjet ndërkombëtare, ndërsa me produktet e reja ushqimore është e pranishme edhe në tregun vendor.

"Ne zakonisht me programin që kemi me fruta të egra, operojmë 98 për qind në vendet evropiane, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtetet Arabe. Po ashtu, në programin tjetër që kemi filluar para tre vjetësh, jemi në tregun e brendshëm vendor, po ashtu bëjmë edhe eksporte jashtë vendit", ka thënë Bajrami.

Ai ka theksuar se ndërprerjet e energjisë elektrike paraqesin problem serioz për bizneset, pasi shkaktojnë humbje dhe dëmtime të inventarit.

Bajrami ka kërkuar që qeveria t'i mbështesë prodhuesit përmes granteve për instalimin e paneleve solare. "Çdo biznes, çdo vend normalisht ka sfida, ka probleme. Për fat të mirë, te ne në kompaninë tonë në zonën e Dragashit nuk kemi pasur shumë reduktime. Por, përkundrazi, është një problem shumë i madh që ndikon si në koston e prodhimit, shkakton humbje, bën prishje të inventarit, ka shumë efekte. Qeveria të jetë krah popullit, përkrahjen, është puna, për shembull, me rrymën, të jenë grante me energji solare, të ndihmojnë pak në kursime që të jetë diçka më e lehtë për përballimin e kostove sa i përket prodhimtarisë. Zakonisht, punëtorë vjetorë i kemi 35 deri në 40, kurse sezonalë shkon deri në 100", ka theksuar ai.

Ndërsa Samir Durmishi, drejtor në kompaninë "SANY" Sh. P. K., me seli në Prizren, e cila merret me prodhimin e pastave dhe jufkave artizanale, ka thënë se ndërprerjet e energjisë elektrike po e vështirësojnë ndjeshëm punën e fabrikës. Ai ka sqaruar se përdorimi i gjeneratorëve është tepër i kushtueshëm dhe se kompania nuk mund ta përballojë prodhimin në këtë mënyrë, ndërsa reduktimet, sipas tij, po ndodhin pothuajse çdo ditë.

"Kryesisht operojmë vetëm në tregun e Kosovës për momentin. Jemi duke shikuar për tregje të tjera. Sfida për mungesën e energjisë elektrike është duke na shkaktuar shumë dëm, ku me gjenerator është kosto e papërballueshme për prodhimin. Domethënë, ne nuk mundemi me punuar me gjenerator. Ndërprerje kemi gati thuajse çdo ditë, ku është shumë problem edhe për prodhimin, edhe për punëtorët, edhe për të gjitha, për arsye se nuk po mundemi t'i përballojmë ndryshe", ka potencuar ai.

Durmishi ka ngritur shqetësimin edhe për rritjen e kostove të prodhimit, duke thënë se çmimet e lëndës së parë dhe derivateve ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e kompanisë. Ai ka kërkuar mbështetje për prodhuesit, duke përmendur edhe lehtësirat në zbatimin e



TVSh-së si një nga mundësitë për uljen e barrës financiare. "Çmimi te kostot e prodhimit është duke ndikuar shumë, ku ka ndikuar edhe te lënda e parë, edhe te derivatet, sepse çdo gjë varet, pasi ne çdo gjë e kemi lëndë të parë, e kemi miellin, ku çdo gjë është e lidhur me derivatet. Ka ndikuar, por po presim një stabilizim të çmimeve të derivateve. Unë mendoj që ka plot lloje, plot mundësi për të na ndihmuar. Një ndër mundësitë është edhe zbatimi i TVSh-së, që ndikon shumë te ne si prodhues", ka theksuar Durmishi.

NË LLAPUSHNIKUN HEROIK, ATY KU U THYE SERBIA PUSHTUESE, PËRJETËSOHEN TRI EPOKA TË LAVDISË KOMBËTARE, GJERGJ KASTRIOTI, PJETËR BOGDANI DHE ADEM JASHARI



Ismet SYLEJMANI

Faleminderit për ftesën, i nderuari shoku, miku dhe bashkëluftëtari ynë trim e sypatrembur, Ismet Sopi-Marini!

Ishte nder dhe privilegj i veçantë për mua të isha pjesëmarrës në atë ngjarje madhështore kombëtare, ku, në kuadër të festave të Nëntorit të lavdishëm shqiptar, në Kishën Katolike Shqiptare në Llapushnikun heroik, u nderuan tri figura madhore të historisë tonë kombëtare!

Kryeheroi i përjetshëm i Kombit shqiptar, Gjergj Gjon Kastrioti – Skënderbeu, personaliteti i shquar i historisë, kulturës dhe identitetit shqiptar, Pjetër Tadej Bogdani dhe Komandanti Legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Shaban Jashari!

Shumë i nderuari shqiptari i madh, atdhetari dhe patrioti i shquar i kombit tonë, Ismet – Marin Sopi !

Ftesa Jote për mua ishte nderim i madh, sepse aty ku nderohen dhe përjetësohen figurat më madhore të historisë shqiptare, aty ku shpalosen monumentet e Gjergjit, Pjetrit dhe Ademit, si simbole të qëndresës, të identitetit dhe të luftës shekullore për liri kunder pushtuesve osman e serb, faleminderit qe ma bëre të mundur të mos mungoja!

Prandaj, me respektin dhe mirënjohjen më të thellë, edhe njëherë të falënderoj që më ftove dhe më bëre pjesë të një ngjarjeje të jashtëzakonshme, e cila do të shkruhet me shkronja të arta në historinë moderne të popullit shqiptar të Kosovës në veçanti dhe të shqiptarizmës në përgjithësi!

Ishte në nderin tim që atë natë të paharruar të 22 Nëntorit 2026, pikërisht në përvjetorin e 118-të të Kongresit historik të Manastirit, kur rilindësit dhe mendjet më të ndritura të kombit tonë i dhanë gjuhës shqipe alfabetin e njësuar me shkronja latine euroatlantike, të isha pjesëmarrës në këtë manifestim të madh me përmasa kombëtare!

Atë natë, në Kishën Shqiptare Katolike në Llapushnik, gjithashtu pata kënaqësinë dhe nderin e madh të isha bashkë me shumë miq, shokë, bashkëluftëtarë, atdhetarë dhe patriotë të dëshmuar të çështjes tonë kombëtare!

Në mesin e tyre ishin edhe Munollët e Pollatës legjendare, me Heroin e Gjallë të Kombit, Ibush Munollin, Kryepersonazhin mitik të betejës heroike të 13 Shtatorit 1990 kundër forcave policore-ushtarake serbe në Pollatë të Llapit! Prania e tij dhe e Munollëve të tjerë të Pollatës i dha asaj mbrëmjeje një peshë të veçantë historike, sepse aty ishte njëri nga protagonistët e gjallë të qëndresës shqiptare, një dëshmitar i një kapitulli heroik të përballjes frontale me njësitet pushtuese serbe!

Bashkë me ta ishin edhe burra të tjerë të nderuar, atdhetarë dhe patriotë të dëshmuar, ndër të cilët atdhetari e patrioti, ish i burgosuri politik Ali Latifi, vëlla i Komandantit të lavdishëm të UÇK-së Muhamet Latifit, Arsim Latifi, djali i atdhetarit të madh, patriotit të shquar dhe ish-të burgosurit politik me 18 vite burg të paharruarit Avdi Larifi, si dhe atdhetari Afrim Xh Fusha, bashkë me vëllanë dhe nipërit e tij!

Prania e këtyre burrave, me histori familjare të lidhura me mbijetesen, qëndresën dhe luftën për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, dëshmoi se ajo mbrëmje nuk ishte vetëm një manifestim solemn, por një takim i brezave që e kanë mbajtur gjallë idealin e luftës për liri dhe bashkimit kombëtar!

Ismet Sopi – Marini, atdhetari, patrioti, ish i burgosuri politik, intelektuali i shquar shqiptar dhe lufteyati e Komandanti me armë në duar i UÇK-se në Drenicë, me kontributin e tij të madh gjatë luftës dhe pas saj, në shërbim të çështjes shqiptare, ka dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm ndaj vlerave historike, shpirtërore, kulturore dhe kombëtare te popullit shqiptar!

Me ngritjen e Kishës Shqiptare Katolike në zemër të teritorit te lirë të Llapushnikut, ai ka lënë një vepër me domethënie të veçantë historike e kombëtare, e cila ngrihet si simbol i identitetit, i besimit, i mbijetesës, qëndresës dhe i kujtesës tonë historike kombëtare!

Dhe jo rastësisht epiqendra është në Llapushnik!

Në Llapushnikun heroik, ku poshtë shtrihet Gryka legjendare e Llapushnikut, vendi i barikadës së lavdishme të Grykes se panënshtruar, të cilën hordhitë ushtarako-policore serbe nuk arritën të kalonin, sepse për ditë e netë, javë dhe muaj ushtarët trima e dragonj të heroizmit masiv skenderbegian të UÇK-së, e mbajtën të pashkelur nga tanket dhe makineria ushtarako-policore e Serbisë pushtuese, ndërsa lartë Pallaniku dhe vargmali i Berishës se lavdishme, me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me Radion Kosova e Lirë dhe Agjencinë e Lajmeve KosovaPress, qëndronin kurora të papaushtuara shqiptare!

Aty ku fjala e lirë shqiptare, përmes Radios Kosovës së Lirë dhe Agjesisë së lajmeve KosovaPress, shpërndante në botë zërin e një



populli heronjësh që luftonte për liri e çlirim, aty ku vepronte dhe qëndronte një pjesë e rëndësishme e organizimit të luftës çlirimtare, ushtria dhe policia serbe nuk arritën ta mposhtnin dhe ta shuanin zërin e lirisë, të qendresës dhe luftës së armatosur shqiptare!

Ndonëse dora e djathë e xhelatit Milosheviq, krimineli famëkeq Vojislav Sheshel kërcënonte me mposhtjen dhe pushtimin e Kleçkës, Ti i nderuar heroi i gjallë i luftës së armatosur bashkë me bashkëluftëtarë, e mbajtëe simbolikën, dhe Berisha mbeti e pashkelur dhe e pamposhtur e lidhur përgjithmonë me historinë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe simbol i luftës frontale të heroizmit masiv të Komandantit Legjendar të UÇK-së Adem Jashari me familje!

Ngritja e Kishës Shqiptare Katolike pikërisht në atë hapësirë historike nuk përfaqëson vetëm një vepër fetare dhe arkitekturore, por ajo është një vepër me mesazh të thellë kombëtar, që lidh trashëgiminë shpirtërore të shqiptarëve të lashtë me historinë e tyre të përgjakshme për liri, dinjitet dhe ekzistencë mbinjerëzore kombëtare!

Vendosja e monumenteve të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, Pjetër Bogdanit dhe Adem Jasharit, në atë hapsirë me histori lavdimadhe përbën një bashkim simbolik të tri epokave të mëdha të historisë tonë kombëtare!

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, simboli i qëndresës shekullore shqiptare për liri dhe mbrojtjen e Atdheut nga pushtimi osman!

Pjetër Bogdani, simboli i i luftës me armë në duar, i dijes, i kulturës, i gjuhës dhe i vetëdijes tonë historike e kombëtare!

Adem Jashari, simboli i sakrificës sublime, i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe i flijimit të jashtëzakonshëm për lirinë e Kosovës!

Tri figura madhore, tri epoka historike, por një ideal i përbashkët, liri, ekzistencë e përjetshme dhe dinjitet euroatlantik të Kombit Shqiptar!

I dashur shoku dhe bashkëluftëtari ynë, Ismet Sopi – Marini!

Ti, me këtë vepër dhe me këtë manifestim, ke dëshmuar se historia e kombit nuk nderohet vetëm me fjalë dhe me përkujtime solemne, por edhe me vepra që mbeten dëshmi për brezat që vijnë!

Monumentet nuk janë vetëm gurë të skalitur dhe figura të ngritura në piedestal, ato janë më shumë, shumë më shumë!

Monumentet janë kujtesa e gjallë e një populli, janë amaneti i të parëve tanë, janë dëshmia e mbijetesës tonë shekullore kombëtare dhe porosia që historia ua përcjell brezave të ardhshëm me saktësi!

Bustet e të mëdhenjëve të Kombit na kujtojnë se liria nuk erdhi dhuratë, se identiteti ynë nuk u ruajt pa sakrifica heroike dhe se rruga jonë historike është ndërtuar mbi mbi luftërat e armatosura dhe në themele ka gjakun dhe idealet e shumë brezave shqiptarësh të shkrirë për çdo gjë shqiptare!

Prandaj, nata e 22 Nëntorit 2026, në Llapushnikun e lavdishëm, aty ku qëndronte e heshtur dhe e bardhë Nëna e Planetit njerëzor, Nënë Tereza, do të mbetet për mua një kujtim i paharruar, një përjetim i veçantë shpirtëror, atdhetar dhe kombëtar!

Faleminderit, i nderuari Ismet Sopi – Marini, për ftesën, për respektin, për veprën dhe për kontributin Tënd të çmuar në shërbim të historisë dhe të identitetit tonë origjinal kombëtar!

Lavdi e përjetshme Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, Pjetër Bogdanit dhe Komandantit Legjendar Adem Jashari!

Lavdi të gjithë heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të kombit shqiptar!

Llapushniku heroik, Gryka e tij legjendare dhe malet e Berishës së lavdishme, do të mbeten përgjithmonë pjesë e artë e memories historike të luftës për liri dhe e krenarisë tonë kombëtare!

Prishtinë, 23 Nëntor 2026!

NGA SAM ALTMAN TE STEVE JOBS

RASTI I JENSEN HUANG NUK ËSHTË I PARI, RIKTHIMET MË TË BUJSHME NË BOTËN E TEKNOLOGJISË! CEO-t QË U LARGUAN DHE MORËN SËRISH DREJTIMIN

Largimi dhe rikthimi i shpejtë i drejtuesve të kompanive të mëdha të teknologjisë ka rikthyer vëmendjen te disa prej historive më të bujshme të biznesit botëror. Rasti i Jensen Huang nuk është i pari i këtij lloji, pasi edhe emra të njohur si Sam Altman, Steve Jobs, Bob Iger dhe Jack Dorsey kanë përjetuar largime nga drejtimi i kompanive të tyre, për t'u rikthyer më pas në krye të tyre, shkruan BBC.

Më poshtë janë disa nga rikthimet më të njohura në historinë e kompanive të mëdha.

Sam Altman – OpenAI (4 ditë)

Një nga rikthimet më të shpejta ishte ai i Sam Altman, bashkëthemeluesit të OpenAI, kompanisë që qëndron pas ChatGPT.

Në nëntor të vitit 2023, Altman u shkarkua nga bordi drejtues, i cili deklaroi se ai nuk kishte qenë vazhdimisht i sinqertë në komunikimet me të. Largimi shkaktoi reagime të forta brenda kompanisë, ndërsa qindra punonjës kërcënuan me dorëheqje nëse ai nuk rikthehej.

Pas vetëm katër ditësh, Altman u rikthye në drejtimin e OpenAI-t, duke i dhënë fund një prej krizave më të bujshme në industrinë e inteligjencës artificiale.

Historia e Steve Jobs është një nga shembujt më të njohur të rikthimit në botën e biznesit.

Bashkëthemeluesi i Apple u largua nga kompania në vitin 1985, pas një përplasjeje për pushtetin me drejtuesit e saj, përfshirë John Sculley.

Megjithatë, në vitin 1996, Apple bleu kompaninë NeXT, të themeluar nga Jobs, duke hapur rrugën për rikthimin e tij. Një vit më vonë, ai mori drejtimin e kompanisë dhe udhëhoqi transformimin që solli produkte si iMac, iPod, iPhone dhe iPad.

Bob Iger u largua nga drejtimi ekzekutiv i Disney-t në fund të vitit 2021, por qëndrimi i tij jashtë këtij posti zgjati më pak se një vit.

Pas vështirësive financiare, rënies së vlerës së aksioneve dhe humbjeve në platformën Disney+, kompania vendosi ta rikthente në nëntor 2022.

Iger pranoi të merrte sërish drejtimin e gjigantit mediatik, me synimin për të stabilizuar kompaninë dhe për të përgatitur kalimin te një drejtues i ri.

Jack Dorsey – Twitter (3 vjet)

Edhe historia e Jack Dorsey në Twitter përfshin një largim dhe rikthim të bujshëm.

Dorsey u largua nga posti i CEO-s në vitin 2008, por u rikthye në kompaninë që kishte bashkëthemeluar fillimisht si kryetar ekzekutiv në vitin 2011.

Në vitin 2015, ai mori sërish



drejtimin e kompanisë si CEO, duke qëndruar në këtë pozicion deri në vitin 2021, kur dha dorëheqjen.

Historia e këtyre drejtuesve tregon se largimi nga drejtimi i një kompanie nuk është gjithmonë fundi i karrierës në të. Në disa raste, krizat e brendshme, presioni i punonjësve apo vështirësitë ekonomike kanë bërë që bordet të rikthejnë pikërisht personat që më parë kishin larguar.

'SHUMË I MADH PËR T'U SHKARKUAR' – PRAPASKENAT E RIKTHIMIT TË JENSEN HUANG, PAS HISTORISË TË TRADHTISË QË TRONDITI SHBA

Ka pasur tre momente tronditëse në orët e fundit rreth rikthimit të Jensen Huang si drejtor ekzekutiv i Nvidia-s, pasi ai pranoi një aferë me një grua që dyshohej se ishte spiune kineze.

Njoftimi tronditës i rikthimit të tij në kompaninë prodhuese të çipave u pasua nga shtimi i 1 trilion dollarësh në vlerën e tregut të aksioneve për Nvidia-n.

Më pas ishte momenti kur Presidenti Trump pranoi qartë: se ishte mesazhi i tij "Je i papushueshëm" drejtuar bordit që ndryshoi vendimin. Natyra e kthesës 180-gradëshe është e qartë nga ajo që tha Nvidia javën e kaluar. Bordi ishte i qartë se Huang nuk do të kthehej.

Menaxhmenti i përkohshëm kishte sugjeruar gjithashtu disa ndryshime në strategji pas epokës Huang. E gjithë ajo tani është në koshin e plehrave të historisë së korporatës.

Ky është një rikthim që tejkalon rikthimin e Sam Altman në OpenAI ose të Steve Jobs në Apple, për sa u përket shifrave të përgjithshme.

Arsyeja e ndryshimit të qëndrimit ishte mjaft e qartë që në deklaratën e parë. Qeveria amerikane kishte thënë se nuk kishte shqetësime për sigurinë kombëtare me rikthimin e tij në detyrë. Një siguri e tillë mund të kishte ardhur vetëm nga Shtëpia e Bardhë.

Dhe një orë më vonë, presidenti Trump zbuloi se kishte folur drejtpërdrejt me bordin e Nvidia-s.

Këtu kthehemi te biseda ime me Jensen Huang shtatorin e kaluar, ku ai mbështeti hapur lejimin e aksesit kinez në mikroçipat e përparuar të Nvidia. Ai ishte një nga të paktët njerëz në botë që mund të thoshte me bindje se i njihte mendjet si të Presidentit Trump ashtu edhe të Presidentit Xi.

Raportet në SHBA thonë se ka pasur përçarje në administratën Trump midis përkrahësve të Kinës që duan të kufizojnë eksportet dhe të tjerëve që mbështesin argumentin e Huang. Ende ekziston një hetim i pavarur mbi pajtueshmërinë e kompanisë me kontrollet e eksportit.

Çipat e Nvidia-s janë kritikë për zhvillimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në nivel të lartë. Ndikimi i Jensen Huang mbi këtë linjë zhvillimi nënkuptonte se ai ishte më i rëndësishëm se shumë udhëheqës botërorë.

Ky është një veprim me rëndësi jo vetëm për bumin e dobët të aksioneve të teknologjisë në SHBA, por edhe për të ardhmen



e ekonomisë botërore, të politikës amerikane dhe sigurisht, garën gjeopolitike midis SHBA-së dhe Kinës.

Dyshimet e fundit rreth Nvidia-s goditën në zemër të bumit të inteligjencës artificiale. Në fund të fundit, kjo është një kompani që gjeneron sasi fenomenale shitjesh reale - mbi 400 miliardë dollarë këtë vit, krahasuar me 27 miliardë dollarë 4 vjet më parë.

Vlerësimi i tregut të aksioneve të Nvidia është përdorur si një formë kritike financimi për kompani të tjera për të ndërtuar qendra të të dhënave. Një rrjet kompleks kredish, garancish dhe aksionesh ndihmoi në përhapjen dhe mbështetjen e bumit të inteligjencës artificiale.

Largimi i Jensen Huang kishte ngritur dyshime rreth brishtësisë së këtij sistemi dhe menaxhmenti i përkohshëm kishte sugjeruar një qasje më "të disiplinuar dhe selektive".

Shqetësimet në lidhje me të ashtuquajturin "financim rrethor" ende ngrenë shqetësime nga disa analistë. Reagimi i publikut kundër qendrave të të dhënave dhe inteligjencës artificiale, i dukshëm në zgjedhjet e mesit të mandatit në SHBA, tregon gjithashtu një mjedis të ndryshuar.

Demokratët në Kongres janë zotuar të hetojnë si Presidentin ashtu edhe z. Huang, dhe ai pritet të paraqitet para tyre javën e ardhshme. Jensen Huang është në qendër të të gjithave - teknologjisë, financimit, politikës amerikane dhe gjeopolitikës. Sot ka vërtetuar se Jensen Huang ishte në fakt "shumë i madh për t'u shkarkuar".

BBC

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Ermali" Sh.p.k. Deçan për Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8856/MMPH, për seperimin e inerteve në Shishman- Gjakovë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 15.12.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Restaurant ' Te Leo ' në fshatin Shishman, Gjakovë, do të organizohet debat publik nga operatori "Ermali" Sh.p.k., Deçan, për Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8856/MMPH, për seperimin e inerteve në Shishman- Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
https://us04web.zoom.us/j/4568731576?pwd=xFtnVeXXQaJwNfDlla8Io3n250tMf6.1

ID: 456 873 1576
Passcode: mQ7kmg

Linku i Komunës:

Linku i gazetës ditore:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

Ermali Sh.p.k.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Ermali" Sh.p.k. Deçan për Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8856/MMPH, për seperimin e inerteve në Shishman- Gjakovë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 15.12.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Restaurant ' Te Leo ' në fshatin Shishman, Gjakovë, do të organizohet debat publik nga operatori "Ermali" Sh.p.k., Deçan, për Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8856/MMPH, për seperimin e inerteve në Shishman- Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
https://us04web.zoom.us/j/4568731576?pwd=xFtnVeXXQaJwNfDlla8Io3n250tMf6.1

ID: 456 873 1576
Passcode: mQ7kmg

Linku i Komunës:

Linku i gazetës ditore:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

Ermali Sh.p.k.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESE DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES